**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**KESHILLI KOMBETAR I UJIT**
**KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE", VLORE**

---

# VENDIM
## Nr. 12, Dt. 25.09.2007

Per miratim te lejes se rinovuar, per shfrytezim inertesh ne shtratin e lumit Drino, ne nje mjedis teresisht lumor, ne zonen e Kordhoces, ne afersi te fshatit Lazaratit (ne veri-lindje te tij), subjektit "Ndertuesi Boci" sh.p.k. komuna Lazarat, Qarku Gjirokaster.

Ne zbatim te kerkesave qe percakton Ligji Nr.8093 Dt. 21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", konkretisht, neni 8 dhe 20, vendimit nr. 1 dhe nr. 3, dt.21.06.2006, te K.K.U-se, si dhe vendimit nr.1 dhe nr.2 dt. 07.06.2007 te K.K.U-se, duke gjykuar mbi kerkesen dhe studimin e paraqitur nga subjekti "Ndertuesi Boci" sh.p.k, konform formularit "F", miratuar me vendimin nr.2, dt. 07.06.2007 te K.K.U-se, pasqyruar dhe ne relacionin shoqerues, paraqitur nga A.U.B "Vjose".

Keshilli i Basenit Ujembledhes "Vjose",

## VENDOSI:

1- Te miratoj lejen e rinovuar, per shfrytezim inertesh ne shtratin e lumit Drino, ne zonen e Kordhoces, ne afersi te fshatit Lazaratit (ne veri-lindje te tij), Komuna Lazarat, subjektit "Ndertuesi Boci" sh.p.k. Gjirokaster.

2- Siperfaqja e dhene ne shfrytezim do te jete 0.07 $km^{2.}$
E kufizuar nga piketat, me koordinata si me poshte:

| | |
|---|---|
| X 1 = 44 37 508 | Y 1 = 44 29 000 |
| X 2 = 44 37 502 | Y 2 = 44 29 318 |
| X 3 = 44 37 405 | Y 3 = 44 29 554 |
| X 4 = 44 37 255 | Y 4 = 44 29 765 |
| X 5 = 44 37 137 | Y 5 = 44 30 035 |
| X 6 = 44 36 914 | Y 6 = 44 30 255 |

- Vazhdim i Projekt - Vendimit Nr. 12, Dt. 25.09.2007.

| | |
|---|---|
| X 7 = 44 36 673 | Y 7 = 44 30 206 |
| X 8 = 44 37 065 | Y 8 = 44 30 005 |
| X 9 = 44 37 105 | Y 9 = 44 29 667 |
| X 10 = 44 37 270 | Y 10 = 44 29 486 |
| X 11 = 44 37 425 | Y 11 = 44 29 288 |
| X 12 = 44 37 443 | Y 12 = 44 29 000 |

3- Koha e shfrytezimit te zones do te jete ajo e percaktuar ne vendimin nr.1, dt. 21.06.2006 te K.K.U-se, nga dt.01.06.2007 deri me 31.10.2007, duke u ricikluar cdo vit, deri me dt. 25.09.2010, duke vazhduar: nga 01.06.2008 deri 31.10.2008
nga 01.06.2009 deri 31.10.2009
nga 01.06.2010 deri 25.09.2010

4- Volumi i materialit qe do te merren per 3 vjet do te jete 120 000 $m^3$, me nje mesatare vjetore 40 000 $m^3$/vit, brenda zones qe jepet ne shfrytezim, thellesia e shfrytezimit deri ne 2 m, por jo me shume se 0.5m mbi pasqyren e ujrave fratike.

5- Ngarkohet A.U.B "Vjose" per zbatimin e ketij vendimi.

6- Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

**PERGJEGJES I A.U.B-se "VJOSE"**
**Vezir METAJ**

**KRYETARE E K.B.U-se**
**Dorothe KONOMI**